

VENDIM
Nr. 801, datë 30.9.2015

**PËR SHPËRBLIMIN E PRONARËVE MBI SIPËRFAQET TAKUESE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET
INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1 e 3, të nenit 15/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, pika 1, shkronja “c”, e 5, pika 2, të ligjit nr. 10239, datë 25.2.2010, “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e pronarëve mbi sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, të zëna nga ndërtimet informale në qarqet e Tiranës, Elbasanit, Korçës, Kukësit, Lezhës dhe Vlorës.

2. Vlera e përgjithshme e kompensimit të jetë 546 582 070,8 (pesëqind e dyzet e gjashtë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë presje tetë) lekë dhe sipërfaqja që shpronësohet të jetë 46 921,2 (dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e njëzet e një presje dy) m², sipas tabelës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të kryejë ndryshimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama